



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

01-1607



Në bazë të nenit 21,22, 44, 50 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.20/21 Qershor 2016, Prishtinë), Vendimit të Kryetarit Nr. 14-464/01-206806/22 dt. 21.09.2022 dhe duke vendosur sipas kërkesës me 05-350/03-213066/22 dt. 06.10.2022, në emër të pronarit/investitori “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe pronari/investitorit “Alko Group” sh.a. për plotësim dhe ndryshimin, **përkatësisht zgjerimin e kompleksit të planifikuar për bllokun ‘A11’**, të miratuara me “Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore” **05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019**, në emër të Blerim Gërvalla, Besim Gërvalla, Arbër Statovci, Hakif Ramadani, Basri Pllana, Lulzim Bunjaku, Bekim Vokri, Jakup Ibishi, Vedat Uka, Bekim Uka, Aferdita Kunoviku, Merita Zharku, Valdet Uka, Nexhmedin Statovci, Faton Sejdiu, Milaim Vitia, Selim Ibrahim, Sami Kunoviku, Bashkim Selimi, Ilir Rama, Driton Rustemaj, Emri Gashi, Izet Zeqiri, Skender Bucolli, Amir Bucolli, Mark Gjoni, Bedrije Demaj, Anita Mulolli-Vrajolli, Jahir Mulolli, Mehdi Berisha dhe Nuriye Pllana e Sinan Pllana nga Prishtina, me investitor "Pozhegu Brothers", sh.p.k., me adresë në Ir "Hasan Jashari", BLL. C11/A/4, lok.6, lagja "Mati I" në Prishtinë, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin me ndërtesave shumë banesore dhe afariste - Lam. "A11/L4" me etazhitet -3B+S+P+10, "A11/L6" me etazhitet -3B+S+P+11, "A11/L7" me etazhitet 3B+S+P+11, "A11/L8" me etazhitet -2B+S+P+11, "A11/L9" me etazhitet -2B+S+P+10, "A11/L10" me etazhitet -2B+S+P+10, "C5/L1" me etazhitet -2B+S+P+8, "C5/L2" me etazhitet -3B+S+P+8, "C5/L3" me etazhitet -2B+S+P+7, si fazë e I-rë, dhe "A11/5" me etazhitet -2B+S+P+5, si fazë e II-të, në kuadër të Blloqeve urbane "A11" dhe "C5", Tërësia "A" dhe "C", të Planit Rregullues "Mati I" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative me dt.13.03.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLOTËSIMIT DHE NDRYSHIMIT TË VENDIMIT 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019

I. Miratohet kërkesa 05-350/03-213066/22 dt. 06.10.2022, në emër të pronarit/investitori “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe pronari/investitorit “Alko Group” sh.a. për plotësim dhe ndryshimin, përkatësisht zgjerimin e kompleksit të planifikuar për bllokun ‘A11’, të miratuara me “Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore” 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019.

II. Ndryshohet dhe plotësohet “Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore” **05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019**, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, në emër të pronarëve: Blerim Gërvalla, Besim Gërvalla, Arbër Statovci, Hakif Ramadani, Basri Pllana, Lulzim Bunjaku, Bekim Vokri, Jakup Ibishi, Vedat Uka, Bekim Uka, Aferdita Kunoviku, Merita Zharku, Valdet Uka, Nexhmedin Statovci, Faton Sejdiu, Milaim Vitia, Selim Ibrahim, Sami Kunoviku, Bashkim Selimi, Ilir Rama, Driton Rustemaj, Emri Gashi, Izet Zeqiri, Skender Bucolli, Amir Bucolli, Mark Gjoni, Bedrije Demaj, Anita Mulolli-Vrajolli, Jahir Mulolli, Mehdi Berisha dhe Nuriye Pllana e Sinan Pllana nga Prishtina, me investitor "Pozhegu Brothers", sh.p.k., me adresë në Ir "Hasan Jashari", BLL. C11/A/4, lok.6, lagja "Mati I" në Prishtinë, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin me ndërtesave

shumë banesore dhe afariste - Lam. "A11/L4" me etazhitet -3B+S+P+10, "A11/L6" me etazhitet -3B+S+P+11, "A11/L7" me etazhitet 3B+S+P+11, "A11/L8" me etazhitet -2B+S+P+11, "A11/L9" me etazhitet -2B+P+10, "A11/L10" me etazhitet -2B+P+10, "C5/L1" me etazhitet -2B+S+P+8, "C5/L2" me etazhitet -3B+S+P+8, "C5/L3" me etazhitet -2B+S+P+7, si fazë e I-rë, dhe "A11/5" me etazhitet -2B+S+P+5, si fazë e II-të, në kuadër të Blloqeve urbane "A11" dhe "C5", Tërësia "A" dhe "C", të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 749-16, 749-14, 749-4, 749-5, 749-6, 749-7, 749-8, 749-18, 749-2, 749-21, 749-23, 747-27, 747-28, 747-31, 747-32, 747-2, 747-19, 747-16, 747-26, 747-29, 747-30, 747-33, 747-5, 747-25, 747-18, 747-17, 749-17, 749-20, 749-22, 747-17, 749-19, 747-22, 747-23, 747-14, 747-15, 747-13, 747-21, 747-24, 747-20 ZK Matiçan.

Ndryshimi dhe plotësimi i "Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore" 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019, ka të bëjë me ndryshimin e zonës së trajtuar në kuadër të bllokut "A11", si në vijim:

- Pika III. shtohen pronaret "Alko Group" sh.a., Sabri Misini, Mustaf Zubaku, Tringa Huruglica, Arben Mushica dhe investitori "Alko Group" sh.a., së bashku me parcelat kadastrale nr. 749-15, 740-20, 747-6, 749-25, ZK Matiçan, ndërsa largohen parcelat kadastrale nr. 747-17, 747-26, 747-29, 747-30 si të pa trajtuara.
- Pika V. përshkrimi i parcelave të shtuara:
 - nr. 749-15; S= 500 m2, "Alko Group" sh.a., Vedat Uka, Bekim Uka, Merita Zharku dhe Valdet Uka..... Arë e klasës 5;
 - nr. 740-20, S= 600 m2, (nga sipërfaqja totale 600 m2, prej tyre 192.17 m2 trajtohet në këtë fazë ndërsa pjesa tjetër 407.83 m2 mbetet e pa trajtuar) Sabri MisiniArë e klasës 5;
 - nr. 747-6, S=203 m2; (nga sipërfaqja totale 203 m2, prej tyre 62 m2 trajtohet në këtë fazë ndërsa pjesa tjetër 141 m2 mbetet e pa trajtuar) Mustaf ZubakuArë e klasës 5;
 - nr. 749-25, S=1141 m2, (nga sipërfaqja totale 1141 m2, prej tyre 896.9 m2 trajtohet në këtë fazë ndërsa pjesa tjetër 244.1 m2 mbetet e pa trajtuar) Selim Ibrahimimi, Arbër Statovci, Bashkim Selimi, Nexhmedin Statovci, Faton Sejdiu, Bekim Vokri, Jakup Ibishi, Sami Kunoviku, Hakif Ramadani, Tringa Huruglica, "Pozhegu Brothers", sh.p.k.Arë e klasës 5;
 - nr. 749-19, S= 28 m2, Selim Ibrahimimi, Arbër Statovci, Bashkim Selimi, Nexhmedin Statovci, Faton Sejdiu, Bekim Vokri, Jakup Ibishi, Sami Kunoviku, Hakif Ramadani, Tringa Huruglica, "Pozhegu Brothers", sh.p.k..... Arë e klasës 5;
 - nr. 749-20, S=55 m2, Selim Ibrahimimi, Arbër Statovci, Bashkim Selimi, Nexhmedin Statovci, Faton Sejdiu, Bekim Vokri, Jakup Ibishi, Sami Kunoviku, Hakif Ramadani, Tringa Huruglica, "Pozhegu Brothers", sh.p.k..... Arë e klasës 5;
 - nr. 749-22, S=474 m2, (nga sipërfaqja totale 474 m2, prej tyre 273 m2 trajtohet në këtë fazë ndërsa pjesa tjetër 201 m2 mbetet e pa trajtuar) Selim Ibrahimimi, Arbër Statovci, Bashkim Selimi, Nexhmedin Statovci, Faton Sejdiu, Bekim Vokri, Jakup Ibishi, Sami Kunoviku, Hakif Ramadani, Tringa Huruglica, "Pozhegu Brothers", sh.p.k..... Arë e klasës 5;
- Pika VI. Kushtet Ndërtimore për bllokun "A11" bëhen:
 - Sipërfaqja e parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale të trajtuara për realizimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste të përfshira –trajtuara brenda vijës rregulluese në bllokun urban "A11": nr. 1660-0 S= 7824.0 m2 (e krijuar sipas Vendimit 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019 nga parcelat kadastrale nr. 749-16, 749-4, 749-5, 749-6, 749-7, 749-8, 749-18, 749-2, 749-21, 749-23, 747-27, 747-28, 747-31, 747-32, 747-2, 747-19, 747-16); nr. 749-14, S=500 m2; nr. 749-15, S= 500.0m2 dhe nr. 747-6 S= 62 m2, me sipërfaqe totale brenda vijës rregulluese S= 8886.0m2.
 - Sipërfaqja e parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale të trajtuara për realizimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste të përfshira –trajtuara jashtë vijës rregulluese në bllokun urban "A11" bëhet:
 - nr. 747-35 S=114 m2;
 - nr. 747-38 S=31 m2;

nr. 747-40 S=114 m²;
 nr. 747-44 S=7 m⁴;
 nr. 749-24 S=1399 m²,
 totali S=1665m² të realizuara sipas Vendimit 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019,
 ndërsa shtohen në trajtim edhe parcelat kadastrale si më poshtë
 nr. 740-20, S=192.17m²
 nr. 749-25, S=896.9 m²
 nr. 749-19, S=28 m²
 nr. 749-20 S=55 m² dhe
 nr. 749-22 S=273 m²

Sipërfaqja totale jashtë vijës rregullues që trajtohet në bllokun "A11" bëhet S=3110 m².

- Ndërtesa shumë banesore dhe afariste në bllokun "A11" :
 A11/L4 _-S= 9041.23 m² (nën toka S=3174.51 dhe mbi toka 5866.72)
 Etazhiteti -3B+S+P+10
 A11/L5 investitor "Alko Group" sh.a. -S= 4641 m² (nën toka S=1341 dhe mbi toka 3300)
 Etazhiteti -3B+P+6+nk
 A11/L6 _-S= 10797.93 m² (nën toka S=2195.7 dhe mbi toka 8602.23)
 Etazhiteti -3B+S+P+12
 A11/L7 _-S= 6648.7 m² (nën toka S=2039.75 dhe mbi toka 4608.95)
 Etazhiteti -3B+S+P+11
 A11/L8 _-S= 10299.41 m² (nën toka S=3930 dhe mbi toka 6369.41)
 Etazhiteti -2B+S+P+10
 A11/L9 _-S= 5213.29 m² (nën toka S=1131.05 dhe mbi toka 4082.24)
 Etazhiteti -2B+S+P+9
 A11/L10 _-S= 4211.53 m² (nën toka S=1053.17 dhe mbi toka 3158.36)
 Etazhiteti -2B+S+P+8

Totali i sipërfaqes ndërtimore mbi tokë për bllokun "A11" bëhet 35987.91m².

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHP), konkretisht shfrytëzimi i parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesave në bazë-gabaritin e përdhësës ose suteranit është max. 0.40 (40 %), dhe sipas llogarive për bllokun "A11" është:
 $S=8886 \times 0.4 = 3554.4 \text{ m}^2$ /lejuar sipas planit rregullues /,
 $S=3307.31 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit, për përdhësë dhe suteran /;
- Në kuadër të kompleksit Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHPN), konkretisht shfrytëzimi i parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesave në bazën-gabaritin e bodrumit, është max. 0.60 (60 %), sipas planit rregullues dhe bazuar në paragrafin II, pika 1. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:
 $S=8886 \times 0.6 = 5411.574 \text{ m}^2$ / lejuar sipas planit rregullues dhe Vendimit të Kryetarit /;
 $S=5410.61 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /;
- Në kuadër të kompleksit të planifikohet edhe hapësira gjelbëruese (ISGJ) min. 20%, me gjelbërim të lartë , të ulët dhe të organizuar për sport dhe rekreacion. Sipërfaqja gjelbëruese sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit është:
 $S=8886 \times 0.2 = 1777.2 \text{ m}^2$ / lejuar sipas planit rregullues dhe Vendimit të Kryetarit /;
 $S=1777.6 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /;
- Koeficienti i ndërtimit të etazheve të mbi tokës (ISHN) sipas Vendimit 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019 është 3.0, pra koeficienti ndërtimor i parcelave kadastrale të bashkuara brenda vijës rregulluese për bllokun "A11" bëhet:
 $S=8886 \times 3 = 26658 \text{ m}^2$ /lejuar sipas planit rregullues /;
- Me aplikimin e Vendimit të Kryetarit Nr. 14-464/01-206806/22 dt. 21.09.2022 për shpronësimin e parcelave për realizimin e ndërtesave të planifikuara për interes publike, me koeficient të ndërtimit, do të mundësohet që sipërfaqja e parcelës ndërtimore (brenda

vijës rregulluese) të shtohet deri në 35 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore, dhe sipas kësaj, kjo sipërfaqe, përcaktuar në përqindje (%) është: $S=3110.1\text{m}^2 / 8886 \times 100=35\%$, prej kësaj bazuar në Vendimin 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019, sipërfaqja prej $S= 1665\text{m}^2 / 8886 \times 100 = 18.7\%$, është kompensuar me sipërfaqe ndërtimore me koeficient të ndërtimit 3.0, si në vijim: $S=1665 \times 3= 4995 \text{m}^2$, e njëjta e realizuar sipas Marrëveshjes nr. 13-464/01-44423/19 dt. 06.08.2019 e lidhur në mes të pronarëve dhe Drejtorisë së Pronës, sipas Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin/shpronësimin e pronës private, të planifikuar për interes publik, me koeficient të ndërtimit, deri në 20 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore. Pjesa e mbetur për shpronësim është $S=3110.1\text{m}^2 - 1665 \text{m}^2= 1445.1 \text{m}^2$ e shprehur në përqindje $S=1445.1/8886 \times 100=16.2\%$ ($18.7\%+16.3\%= 35.0\%$)

$S= 1445.1\text{m}^2 \times 3.0= 4335.3 \text{m}^2$,/lejuar sipas Vendimit të Kryetarit Nr. 14-464/01-206806/22 dt. 21.09.2022;

Pra sipërfaqja totale ndërtimore mbitokë për bllokun urban "A11" bëhet:

$S= 26658+4995+4335.3=35988.3 \text{m}^2$

$S= 35987.91 \text{m}^2$ / sipas projekt propozimit;

- **Pika V. Kompensimi** me koeficient ndërtimi për bllokun "A11" i pjesëve të parcelave kadastrale nr. 747-35 $S=114 \text{m}^2$; nr. 747-38 $S=31 \text{m}^2$; nr. 747-40 $S=114 \text{m}^2$; nr. 747-44 $S=7 \text{m}^2$; nr. 749-24 $S=1399 \text{m}^2$, ZK Matican, me sipërfaqe të përgjithshme $S=1665\text{m}^2 \text{m}^2$, e përfshirë në hapësirë publike, është realizuar sipas Marrëveshjes nr. 13-464/01-44423/19 dt. 06.08.2019 e lidhur në mes të pronarëve dhe Drejtorisë së Pronës bazuar në Vendimin 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019 për caktimin e Kushteve Ndërtimore, sipas kalkulimeve si në vijim $S = 1665\text{m}^2 / 8886 \times 100 = 18.7\%$, me sipërfaqe ndërtimore $S=1665 \times 3= 4995 \text{m}^2$.

Për bllokun "A11", bazuar në Vendimin e Kryetarit Nr. 14-464/01-206806/22 dt. 21.09.2022, për shpronësimin e parcelave për realizimin e ndërtesave të planifikuara për interes publike, me koeficient të ndërtimit, do të mundësohet që sipërfaqja e parcelës ndërtimore (brenda vijës rregulluese) të shtohet deri në 35 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore, dhe sipas kësaj, në trajtim shtohen edhe parcelat kadastrale nr. 740-20, $S=192.17\text{m}^2$; nr. 749-25, $S=896.9 \text{m}^2$; nr. 749-19, $S=28 \text{m}^2$; nr. 749-20 $S=55 \text{m}^2$ dhe nr. 749-22 $S=273 \text{m}^2$, me sipërfaqe totale $S=1445.1 \text{m}^2$ e shprehur në përqindje (%) $S=1445.1/8886 \times 100=16.2\%$ ($18.7\%+16.3\%= 35.0\%$), andaj sipërfaqja $S=1445.1 \text{m}^2$ do të kompensohet me koeficient të ndërtimit 3.0, dhe atë me sipërfaqe ndërtimore: $S=1445.1\text{m}^2 \times 3.0= 4335.3 \text{m}^2$,

Kjo drejtori jep PËLQIM për kompensimin me koeficient ndërtimi të pjesës së parcelës kadastrale, bazuar në këtë vendim. Kjo procedurë e kompensimit me koeficient ndërtimi, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të bashkëpronarëve të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga bashkëpronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, detyron Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore dhe afariste, të përcaktuara me këtë vendim.

- **Pika VI. Ndarja/parcelimi** i parcelës kadastrale, nr. 747-6 ZK Matiçan, do të realizohet sipas pjesës së Bllokut urban "A11", të përcaktuar me vijën rregulluese të planit rregullues urban, si dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtij vendimit dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në, Planin e situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën

ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

- **Pika VII. Bashkimi** i parcelave kadastrale nr. 1660-0, 749-14, 749-15 dhe 747-6 ZK Matiçan dhe formimi i parcelës ndërtimore për kompleksin/ndërtesën, do të realizohet bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore për bllokun “A11”, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues ”Mati 1” në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01. Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përkthuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues ”Mati 1” në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, punuar nga gjeometri i drejtorisë, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

- **Pika XIII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcelat kadastrale nr. 749-14, 749-15 dhe 747-6 ZK Matiçan në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “Arë e klasës 5”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, përcaktohet bazuar në sipërfaqen e parcelave të shtuara në kompleks që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit-“zgjidhja urbane”- parcelës ndërtimore, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S=500+500+62=1062$ m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohesh si tokë ndërtimore, në regjistrat kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, Ky kompensim-pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

III. Ky Vendim për miratimin e plotësim dhe ndryshim të blloku “A11” është pjesë përbërëse e “Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore” **05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019** dhe i njëjti prodhon efekte juridike nga dita e lëshimit të këtij Vendimi.

A r s y e t i m

Pronari/investitori “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe pronari/investitorit “Alko Group” sh.a., me kërkesën 05-350/03-213066/22 dt. 06.10.2022, i janë drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit, të Komunës së Prishtinës, për plotësim dhe ndryshimin, përkatësisht zgjerimin e kompleksit të planifikuar në bllokun ‘A11”, të miratuara me “Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore” 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019, në emër të Blerim Gërvalla, Besim Gërvalla, Arbër Statovci, Hakif Ramadani, Basri Pllana, Lulzim Bunjaku, Bekim Vokrri, Jakup Ibishi, Vedat Uka, Bekim Uka, Aferdita Kunoviku, Merita Zharku, Valdet Uka, Nexhmedin Statovci, Faton Sejdiu, Milaim Vitia, Selim Ibrahim, Sami Kunoviku, Bashkim Selimi, Ilir Rama, Driton Rrustemaj, Emri Gashi, Izet Zeqiri, Skender Bucolli, Amir Bucolli, Mark Gjoni, Bedrije Demaj, Anita Mulolli-Vrajolli, Jahir Mulolli, Mehdi Berisha dhe Nurije Pllana e Sinan Pllana nga Prishtina, me investitor "Pozhegu Brothers", sh.p.k., për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin me ndërtesave shumë banesore dhe afariste - Lam. "A11/L4" me etazhitet -3B+S+P+10, "A11/L6" me etazhitet -

3B+S+P+11, "A11/L7" me etazhitet 3B+S+P+11, "A11/L8" me etazhitet -2B+S+P+11, "A11/L9" me etazhitet -2B+P+10, "A11/L10" me etazhitet -2B+P+10, "C5/L1" me etazhitet -2B+S+P+8, "C5/L2" me etazhitet -3B+S+P+8, "C5/L3" me etazhitet -2B+S+P+7, si fazë e I-rë, dhe "A11/5" me etazhitet -2B+S+P+5, si fazë e II-të, në lokacionin e përkthyer si në pikën I të këtij Vendimi.

Bashkangjitur me kërkesë 05-350/03-213066/22 dt. 06.10.2022, për plotësim dhe ndryshim përkatësisht zgjerimin e kompleksit të planifikuar në bllokun 'A11', të miratuara me "Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore" 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019, si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dhe trajtuar dokumentacioni sin ë vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelat kadastrale nr. 1660-0, 749-14, 749-15 dhe 747-6, 740-20, nr. 749-25, nr. 749-19, nr. 749-20 dhe 749-22 dhe certifikatat e njësjive kadastrale P-71914050-01660-0, P-71914050-00749-14, P-71914050-00749-15, P-71914050-00747-6, P-71914050-00740-20, P-71914050-00749-25, P-71914050-00749-19, P-71914050-00749-20, P-71914050-00749-22 ZK Matičan, lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;
- Projektin konceptual-"zgjdhja urbane", hartuar nga kompania "Pozhegu Brothers" sh.p.k., me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811251032;
- Manualin gjeodezik të ndarjes, bashkimit dhe kompenzimit të punuar nga gjeodeti i licencuar Burim Halilaj, me licencë nr. 195;
- Aktin administrativ "Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore" 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019 (kopje);
- Aktin administrative "Aktvendim për caktimin e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës" 05 nr. 351/02-211011/19 dt. 21.01.2020 si dhe "Vendim për lejimin e ndërtimit" 05 nr. 351/02-211011/19 dt. 04.03.2022 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës "L1/C5";
- Aktin administrative "Aktvendim për caktimin e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës" 05 nr. 351/02-224855/19 dt. 26.05.2019 si dhe "Vendim për lejimin e ndërtimit" 05 nr. 351/02-224855/19 dt. 06.07.2020 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës "C5/L2" dhe "C5/L3";
- Aktin administrative "Aktvendim për caktimin e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës" 05 nr. 351/02-184077/20 dt. 26.01.2021 si dhe "Vendim për lejimin e ndërtimit" 05 nr. 351/02-184077/20 dt. 17.03.2021 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës "L9" dhe "L10";
- Aktin administrative "Aktvendim për caktimin e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës" 05 nr. 351/02-291951/19 dt. 16.02.2021 si dhe "Vendim për lejimin e ndërtimit" 05 nr. 351/02-291951/19 dt. 19.04.2021 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës "L4";
- Aktin administrative "Aktvendim për caktimin e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës" 05 nr. 351/02-208634/20 dt. 20.01.2022 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës "L7" dhe "L8";
- Aktin "Marrëveshje e zotimeve", e lidhur në mes të investitorit "Pozhegu Brothers" sh.p.k, me seli në Prishtinë, me numër të biznesit 81125032, përfaqësuar nga Qemail Pozhegu dhe "Alko Group" sh.a., me seli në Prishtinë, me numër të biznesit 811290329, përfaqësuar nga Petrit Hakaj, me datë 19.07.2022;
- Aktin noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor", e lidhur në mes të pronarit Sabri Hysni Misini nga Drobeshi, Komuna Viti, me investitorin Alko Group" sh.a., me seli në Prishtinë, me numër të biznesit 811290329, përfaqësuar nga Petrit Hakaj, redaktuar dhe noterizuar te noteri Valdete Ademi, në Prishtinë, LRP-Nr. 7463/2022, Ref.nr. 1666/2022, me datë 15.12.2022 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aktin noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore dhe kalimin e kushtëzuar të pronësisë së paluajtshme në investitor", e lidhur në mes të pronarit

Mustaf Zubaku, me investitorin “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë, me numër të biznesit 81125032, përfaqësuar nga Qemail Pozhegu nga Prishtina, redaktuar dhe noterizuar te noteri Sefedin Blakaj, në Prishtinë, LRP-Nr. 14114/2022, Ref.nr. 5156/2022, me datë 30.12.2022 (kopje e vërtetuar nga origjinali);

- Aktin noterial “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore”, e lidhur në mes të investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe pronarit Seljim Ibrahimimi, redaktuar dhe noterizuar te noteri Sefedin Blakaj, në Prishtinë, LRP-Nr. 898/2019, Ref.nr. 190/2019, me datë 30.01.2019 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aktin noterial “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore”, e lidhur në mes të investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe pronareve: Nexhmedin Statovci, Vedat Uka, Bekim Uka, Afërdita Kunoviku, Merita Zharku, Valdet Uka, Faton Sejdiu, Jakup Ibishi, Lulzim Bunjaku, Milaim Vitija, Basri Pllana, Arbër Styatovci, Hakif Ramadani, Blerim Gervalla, Besim Gërvalla, Sami Kunoviku, Bashkim Selimi, Ilir Rama, Driton RRrustemaj, redaktuar dhe noterizuar te noteri Sefedin Blakaj, në Prishtinë, LRP-Nr. 8521/2018, Ref.nr. 1698/2018, me datë 01.08.2018 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aktin noterial “Aneksi i Kontratës për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore, i redaktuar dhe noterizuar te noteri Sefedin Blakaj, në Prishtinë, LRP-Nr. 8521/2018, Ref.nr. 1698/2018, me datë 01.08.2018, si dhe i Aneksit të I-re të se njëjtës, Aneksi i noterizuar nga noteri Sefedin Blakaj me LRP-Nr. 13263/2018, Ref.nr. 2819/2018, dt. 21.12.2018” e lidhur në mes të investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe pronareve: Nexhmedin Statovci, Faton Sejdiu, Bekim Vokri, Jakup Ibishi, Lulzim Bunjaku, Milaim Vitija, Basri Pllana, Arbër Styatovci, Hakif Ramadani, Blerim Gërvalla, Besim Gërvalla, Sami Kunoviku, Bashkim Selimi, Ilir Rama, Driton RRrustemaj, Afërdita Kunoviku, Arben Mushica, Tringa Huruglica, Seljim Ibrahimimi, redaktuar dhe noterizuar te noteri Sefedin Blakaj, në Prishtinë, LRP-Nr. 845/2019, Ref.nr. 181/2019, me datë 29.01.2019 (kopje e vërtetuar nga origjinali)
- Aktin noterial “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore”, e lidhur në mes të investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe pronareve: Jahir Muholli, Anita Muholli-Vrajolli, Izet Zeqiri, redaktuar dhe noterizuar te noteri Sefedin Blakaj, në Prishtinë, LRP-Nr. 3350/2019, Ref.nr. 653/2019, me datë 25.03.2019 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aktin noterial “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore”, e lidhur në mes të investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe pronarit Mehdi Berisha, redaktuar dhe noterizuar te noteri Sefedin Blakaj, në Prishtinë, LRP-Nr. 3971/2019, Ref.nr. 758/2019, me datë 10.04.2019 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me numër të biznesit 81125032;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit “Alko Group” sh.a., me seli në Prishtinë, me numër të biznesit 811290329;
- Vërtetimet mbi obligimet tatimore;
- Kopjen e letërnjoftimit të pronarëve dhe të investitorëve;
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës, 05-350/03-213066/22 dt. 06.10.2022, për plotësim dhe ndryshimin, përkatësisht zgjerimin e kompleksit të planifikuar për bllokun ‘A11’, të miratuara me “Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore” 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019, të lëshuar nga kjo drejtori, dokumentacionin e prezantuar me kërkesa dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës administrative, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, dokumentet e planifikimit hapësinor aktuale - në fuqi për atë zonë urbane / Plani Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, dhe konsultimin e dosjeve nga arkivi i drejtorisë lidhur me kërkesat e trajtuara për këtë lokacion, si kërkesat, 05 Nr.350/02-0168422/18 dt.12.07.2018, për kushte ndërtimore, 05-350/03-89673/19 dt. 17.04.2019, si dhe Vendimit të Kryetarit

Nr. 14-464/01-206806/22 dt. 21.09.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në mënyrë kronologjike konstaton se:

- Kjo drejtori bazuar në kërkesën 05 Nr.350/02-0168422/18 dt.12.07.2018, të pronarëve: Blerim Gërvalla, Besim Gervalla, Arbër Statovci, Hakif Ramadani, Basri Pllana, Lulzim Bunjaku, Bekim Vokri, Jakup Ibishi, Vedat Uka, Bekim Uka, Aferdita Kunoviku, Merita Zharku, Valdet Uka, Nexhmedin Statovci, Faton Sejdiu, Milaim Vitia, Selim Ibrahimimi, Sami Kunoviku, Bashkim Selimi, Ilir Rama, Driton Rrustemaj, Emri Gashi, Izet Zeqiri, Skender Bucolli, Amir Bucolli, Mark Gjoni, Bedrije Demaj, Anita Mulolli-Vrajolli, Jahir Mulolli, Mehdi Berisha dhe Nurije Pllana e Sinan Pllana nga Prishtina, me investitor "Pozhegu Brothers", sh.p.k., me anë të Vendimit 05 Nr.350/02-0168422/18 DT. 29.10.2018, ka caktuar Kushtet Ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste - Lam. "A11/L4" me etazhitet -3B+S+P+10, "A11/L6" me etazhitet -3B+S+P+11, "A11/L7" me etazhitet -3B+S+P+11, "A11/L8" me etazhitet -2B+S+P+11, "A11/L9" me etazhitet -2B+P+10, "A11/L10" me etazhitet -2B+P+10, "C5/L1" me etazhitet -2B+S+P+8, "C5/L2" me etazhitet -3B+S+P+8, "C5/L3" me etazhitet -2B+S+P+7, si fazë e I-rë, dhe "A11/5" me etazhitet -2B+S+P+5, si fazë e II-të, në kuadër të blloqeve urban "A11" dhe "C5", Tërsia "A" dhe "C", të Planit Rregullues "Mati 1".

- Në ndërkohë në këtë drejtori është pranuar kërkesa nr. 05-350/03-89673/19 dt. 17.04.2019, për plotësim dhe ndryshim të "Vendimit 05 Nr.350/02-0168422/18 DT. 29.10.2018 për caktimin e Kushteve Ndërtimore" nga pronaret dhe investitori i lartëcekur. Kjo drejtori bazuar në këtë kërkesë me "Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore" 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019, ka miratuar kërkesën në fjalë.

- Në vazhdim të kronologjisë, kjo drejtori konstaton se të lartë cekurit, pas pranimit të kushteve ndërtimore dhe përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të përcaktuara, si dhe pas hartimit të dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor, bazuar në kërkesës për leje ndërtimore kjo drejtori në kuadër të kompleksit ka lëshuar këto leje ndërtimore "Vendim për lejimin e ndërtimit" 05 nr. 351/02-211011/19 dt. 04.03.2022 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës "L1/C5"; "Vendim për lejimin e ndërtimit" 05 nr. 351/02-224855/19 dt. 06.07.2020 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës "C5/L2" dhe "C5/L3"; "Vendim për lejimin e ndërtimit" 05 nr. 351/02-184077/20 dt. 17.03.2021 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës "L9" dhe "L10"; "Vendim për lejimin e ndërtimit" 05 nr. 351/02-291951/19 dt. 19.04.2021 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës "L4";

- Pronaret Mustaf Zubaku me investitor "Pozhegu Brothers" sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe "Alko Group" sh.a., Sabri Hysni Misini me investitor "Alko Group" sh.a., pas marrje së informacionit se Kryetari i Komunës së Prishtinës, me Vendim Nr. 14-464/01-206806/22 dt. 21.09.2022, për shpronësimin e parcelave për realizimin e ndërtesave të planifikuara për interes publike, me koeficient të ndërtimit, do të mundësohet që sipërfaqja e parcelës ndërtimore (brenda vijës rregulluese) të shtohet deri në 35 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore përmes kërkesës 05-350/03-213066/22 dt. 06.10.2022, dhe dokumentacionit të prezantuar - projekt propozimit konceptual, ka kërkuar nga kjo drejtori, plotësim dhe ndryshimin, përkatësisht zgjerimin e kompleksit të planifikuar në bllokun 'A11', të miratuara me "Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore" 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019, duke shtuar në trajtim për bllokun "A11" edhe parcelat nr.749-15, 747-6 (të ndodhura brenda vijës rregullues të Bllokut "A11") dhe 740-20, 749-25, 749-19, 749-20 dhe nr. 749-22 ZK Matican (jashtë vijës rregullues/zonën me destinim publik) dhe duke planifikuar kompenzim me koeficient të ndërtimit bazuar në Vendimin e Kryetarit Nr. 14-464/01-206806/22 dt. 21.09.2022, për shpronësimin e parcelave për realizimin e ndërtesave të planifikuara për interes publike.

- Kjo drejtori, pas pranimit të kërkesës 05-350/03-213066/22 dt. 06.10.2022, për ndryshim-plotësim dhe zgjerim të kushteve ndërtimore me dokumentacion të prezantuar dhe konsultimin e dokumentit të planifikimit hapësinor për atë hapësirë – Planin Rregullues "Mati 1" dhe PZHU, si dhe Vendim Nr. 14-464/01-206806/22 dt. 21.09.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, konkretisht pikën 2 të vendimit, konstatoi se ka bazë ligjore për trajtimin e kërkesës, andaj edhe ka filluar procedurat e trajtimit të saj.

Bazuar në konstatimet e më sipërme, dokumentacionin e shqyrtuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, si dhe nenit 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", dhe diskercionin për vendose të çështjeve të planifikimit dhe ndërtimit në bazë të neneve 4, 21, 22 dhe 84 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L - 031 dt. 21.07.2016, lidhur me ligjshmërinë për plotësim dhe ndryshimin, përkatësisht zgjerimin e kompleksit të planifikuar në bllokun 'A11", të miratuara me "Vendimin për miratimin e kërkesës 05 Nr. 350/03-89673/19 dt. 17.04.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0168422/18 dt. 29.10.2018, shfuqizimin e tyre dhe ri-caktimin e Kushteve Ndërtimore" 05 Nr. 350/02-89673/19 dt. 17.06.2019 dhe zbatimin e Vendim 14-464/01-206806/22 dt. 21.09.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Vendimit 14nr.350/05 – 0069714/18 dt. 22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, "Për Përcaktimin e Mënyrës së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane", Drejtoria e Urbanizmit konstatoi se kërkuessit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se kërkesa 05-350/03-213066/22 dt. 06.10.2022 e bashkëpronarëve, Blerim Gërvalla, Besim Gërvalla, Arbër Statovci, Hakif Ramadani, Basri Pllana, Lulzim Bunjaku, Bekim Vokri, Jakup Ibishi, Vedat Uka, Bekim Uka, Afërdita Kunoviku, Merita Zharku, Valdet Uka, Nexhmedin Statovci, Faton Sejdiu, Milaim Vitia, Selim Ibrahim, Sami Kunoviku, Bashkim Selimi, Ilir Rama, Driton Rustemaj, Emri Gashi, Izet Zeqiri, Skender Bucolli, Amir Bucolli, Mark Gjoni, Bedrije Demaj, Anita Mulolli-Vrajolli, Jahir Mulolli, Mehdi Berisha dhe Nuriye Pllana, Sinan Pllana, Mustaf Zubaku nga Prishtina me investitor "Pozhegu Brothers" sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe "Alko Group" sh.a., Sabri Hysni Misini me investitor "Alko Group" sh.a., me seli në Prishtinë, mund të miratohet sipas Planit të situacionit - "zgjdhjes urbane" dhe projekt propozimit konceptual të prezantuar.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit për ndryshim-plotësim dhe zgjerim të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Situacioni i ngushtë/Zgjdhja Urbane dhe Manuali Gjeodezik për ndarjen e parcelave sipas ndryshimeve të miratuara me këtë vendim.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror-MMPHI-it.

Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuessit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05-350/03-89673/19 dt. 17.04.2019;

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT, E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/03-89673/19 DT. 13.03.2023**

Zyrtari,
Mimoza Berisha Prestreshi

Udhëheqëse e Sektorit
Nazife Krasniqi

DREJTORI,
Arber Sadiki





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtine


Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: _____

Zona kadastrale / Katastarska zona: Matičan

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____ /2023

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcele

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1600



Rilevoi / Snimio: BURIM HALILAJ
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 195

Nënshkrimi / Potpis: BHalilaj

Data e rilevimit / Datum snimanja: 21.02.2023



Aprovi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i përsorit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

